Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.368, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen S.H., për sa kërkohet në shkresën nr.1195 prot., datë 23.06.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, për shtetasen R.K.Sh.(M.), nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë eurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.369, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen S.H., për sa kërkohet në shkresën nr.1193 prot., datë 23.06.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, për shtetasin K.Sh.Sh., nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.370, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen S.K.H.,(Sh) për sa kërkohet në shkresën nr.1194 prot., datë 24.06.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Au-

toritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë eurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.371, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen H.P.K., për sa kërkohet në shkresën nr.1284 prot., datë 04.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë eurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.377, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin A.A.B., për sa kërkohet në shkresën nr.1330 prot., datë 14.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.378, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin K.K.B., për sa kërkohet në shkresën nr.1388 prot, datë 21.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.379, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin S.T., për sa kërkohet në shkresën nr.1173 prot., datë 18.06.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, për shtetasin H.A.T., nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.380, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin Xh.M., për sa kërkohet në shkresën nr.1329 prot, datë 14.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.381, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin I. Sh., për sa kërkohet në shkresën nr.1310 prot, datë 09.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që V.(V.)J.Sh., të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.382, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin Gj.N.N., për sa kërkohet në nr.1386 prot., datë 21.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.383, datë 18.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasen S.K.H.(Sh.) për sa kërkohet në shkresën nr.1194 prot., datë 24.06.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Au-

toritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë eurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.384, datë 26.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin E.T., për sa kërkohet në shkresën nr.1253 prot., datë 01.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, për shtetasin A.I.T., nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.385, datë 26.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 22 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin F.T., për sa kërkohet në shkresën nr.1487 prot., datë 06.08.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërkimit, për shtetasin I.A.T., nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni

Vendim nr.386, datë 26.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5, nenin 19, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të informojë shtetasin P.N.B., për sa kërkohet në shkresën nr.1381 prot., datë 18.07.2025, ku mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera bazuar në vendimin e Autoritetit, që përcakton protokollin standard të kërimit, nuk ekzistojnë të dhëna që të ketë qenë ndonjëherë iurvejuar apo të ketë dokumente për të në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku dhe Skënder Vrioni



VENDIME

**MBI MBI BAZËN E KËRKESAVE
PËR QËLLIME
STUDIMORE/MEDIATIKE**

Vendim nr. 355, datë 17.07.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 36, 37, 38, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

V E N D O S I:

1. Të vihet në dispozicion për konsultim kërkuesit z. G.M. dokumentacioni dublikatë i mëposhtëm:
 - a) Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, dosje ORV nr.13, Miniera e Bakrit Spaç, me 183 faqe.
 - b) Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, dosje ORV nr.123, Reparti 303 Spaç, me 272 faqe.
 - c) Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pukë, fashikull për masat që merren kur arratisen të burgosurit nga reparti Spaçit, 14 skica, me 16 faqe.
2. Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesi, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kërkuesi duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024 neni 28, pika 5: “Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruara nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit nr. 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat, përcaktuara dhe dokumenton rezultatin. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse.”
4. Kërkuesi, në bashkëpunim me Autoritetin, duhet të zbatojë, për aq sa është e mundur, vënien në dijeni e personave/familjarëve në zbatim të nenit 36 pika 4 të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar).
5. Kërkuesi zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku

Vendim nr. 372, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 36, 37, 38, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

VENDOSI:

1. Të vihet në dispozicion për konsultim kërkueses E. B dokumentacioni dublikatë i mëposhtëm:
 - a) Arkivi i Autoritetit, Fondi 6, Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit, viti 1945, dosje nr. 6, në ngarkim të Mehdi Frashërit, me 167 faqe.
 - b) Arkivi i Autoritetit, Fondi 6, Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit, viti 1945, dosje nr. 6/1 në ngarkim të Mehdi Frashërit, me 90 faqe.
2. Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesja, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kërkuesja duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024 neni 28, pika 5: “Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruara nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat, përcaktuara dhe dokumenton rezultatin. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse.”
4. Kërkuesja në bashkëpunim me Autoritetin duhet të zbatojë, për aq sa është e mundur, vënien në dijeni e personave/familjareve në zbatim të nenit 36 pika 4 të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar).
5. Kërkuesja zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr.45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr. 373, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 36, 37, 38, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

VENDOSI:

1. Të vihet në dispozicion për konsultim kërkueses. E.M. në cilësinë e studentes, dokumentacioni dublikatë i mëposhtëm:
 - a) Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, dosje nr. 3497 në ngarkim të D. M. Çomo, me 102 faqe.
2. Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesja, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kërkuesja duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024 neni 28, pika 5: “Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruara nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat, përcaktuara dhe dokumenton rezultatin. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse.”
4. Kërkuesja në bashkëpunim me Autoritetin duhet të zbatojë, për aq sa është e mundur, vënien në dijeni e per-

sonave/familjareve në zbatim të nenit 36 pika 4 të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar).

5. Kërkesja zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni

Vendim nr. 376, datë 01.08.2025 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 36, 37, 38, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit


V E N D O S I:

1. Të informohet shtetasi Gj.M., për sa kërkohet në kërkesën me nr. 2159 prot., datë 17.12.2024 për qëllime studimore, se, nga kërkimet dhe verifikimet e deritanishme, duke përdorur mjetet e disponuara, nuk janë identifikuar të dhëna arkivore në lidhje me B.K. me emrin e pagëzimit B.C.M., vdekur nga torturat në vitin 1949, në burgun e Shkodrës.
2. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha dhe Skënder Vrioni



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

5 VJET NGA NGJARJA HISTORIKE E 2 KORRIKUT 1990

Tiranë, 02 korrik 2025

Në 35-vjetorin e ngjarjes historike të 2 Korrikut 1990, hyrjes masive të shqiptarëve në ambasada, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) bashkohet me Ambasadën Gjermane në Tiranë për të përkujtuar guximin e mijëra shqiptarëve që sfiduan regjimin komunist duke kërkuar liri në ambasadat e huaja. Ekspozita digjitale e Ambasadës Gjermane (<https://ausstellungen.deutsche-digitale-bibliothek.de/>) sjell pamje dhe dëshmi origjinale të këtyre momenteve që shënuan fillimin e rënies së diktaturës.



Arkiva e AIDSSH-së zbulon anën e errët të regjimit, i cili vijoi të ndiqte refugjatët edhe jashtë kufijve përmes agentëve dhe planeve të detajuara të Sigurimit të Shtetit. Këto dokumente, si ato të dosjes nr. 206 “Mbi hyrjet në Ambasadën Gjermane”, dëshmojnë përpjekjet e regjimit për të kontrolluar dhe frikësuar të ikurit, duke na rikujtuar çmimin e lirisë.

Në këtë përvjetor, ndajmë postimin e Ambasadës Gjermane dhe ftojmë të gjithë të eksplorojnë ekspozitën digjitale për të njohur më shumë nga kjo faqe e rëndësishme e historisë sonë. Ambasadori Bergner tha: “Guximi i Ylli Bodinakut dhe shumë të tjerëve është themeli i aspiratave europiane të Shqipërisë.”

Le të nderojmë sakrificën e atyre që bënë të mundur ndryshimin dhe të angazhohemi për të mbajtur gjallë kujtesën e tyre!

KONKURSI KOMBËTAR

MËSOJTMË NGA E KALUARA, VEPROJMË PËR TË ARDHMEN

Durrës, 08 korrik 2025

U mbajt ceremonia përmbyllëse e turit të leximit dhe i informimit “Mësojmë nga e kaluara, veprojme për të ardhmen” dhe edukimit qytetar “Mësojmë nga e kaluara”, një nismë e përbashkët me Këshillin e Europës në kuadër të projektit “Forcimi për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim, SIDA.





Nga muajt nëntor 2024 deri në prill 2025, mbi 30 shkolla dhe 500 nxënës nga qytete të ndryshme të vendit – Tiranë, Durrës, Elbasan, Përrenjas, Shkodër, Vlorë, Bulqizë etj. – u përfshinë në këtë tur informimi dhe reflektimi dhe u njohën me:

- a) librat, prodhim i plotë i Autoritetit (dokument, tekst dhe imazh i Autoritetit) me titujt: “Dielli lind në Spaç”, “Spaç – historia e një revolte” dhe “Kufij të thyer”;
- b) dokumentari “3 ditët e lirisë në Spaç”;
- c) dëshmitë e të mbijetuarve nga burgjet politike;

si dhe konceptet themelore të të drejtave të njeriut dhe shkëlqes së tyre gjatë diktaturës.



Në përfundim të këtij rrugëtimi të edukimit qytetar, nxënësit sollën krijimet e tyre letrare, artistike dhe audiovizuale, të cilat u vlerësuan gjatë ceremonisë nga një komision i përbashkët i AIDSSH-së dhe KiE-s, duke shpërblyer angazhimin, reflektimin dhe ndjeshmërinë e të rinjve ndaj historisë së vendit tonë.

“Mësojmë nga e kaluara” nuk është vetëm një tur leximi – është një ftesë për të kuptuar të kaluarën, për të ndërtuar një të ardhme me më shumë vetëdije qytetare dhe me respekt për lirinë.

KRYETARJA E AIDSSH-SË, DR. GENTIANA SULA,

NË EMISIONIN “LOG” ME GAZETARIN ENDRI XHAFON


Tiranë, 14 korrik 2025

Në emisionin “Kriza e ambasadave dhe pluralizmi politik” në kanalin televiziv News24, me gazetarin Endri Xhafo, kryetaria e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, theksoi se edhe pse në vendet e Europës Lindore kishin nisur ndryshime të rëndësishme, Sigurimi i Shtetit Shqiptar vazhdonte të mbetej një strukturë represive.

Dokumentet arkivore dëshmojnë për ngjarje tragjike, përfshirë edhe vrasjen nga forcat shqiptare të sigurisë të një të riu 17-vjeçar, Altin Basha, i cili kishte hyrë në Ambasadën Gjermane në përpjekje për t’u larguar nga vendi.

U soll në vëmendjen e publikut historia e jashtëzakonshme e një vajze 18-vjeçare, në muajin e fundit të shtatzënisë, e cila arriti të kapërcejë murin 2.5 metra të lartë të Ambasadës Gjermane dhe lindi vajzën brenda saj më 7 korrik 1990. Ky akt nuk ishte një rastësi, por një zgjedhje e guximshme në një moment dëshpërimi të thellë. Ajo dhe bashkëshorti i saj vinin nga një familje e përndjekur.

Përndjekja nga Sigurimi nuk ndaloi as pas largimit të shqiptarëve jashtë vendit. Refugjatët vijuan të ndiqeshin edhe në vendet pritëse, përmes presioneve dhe incidenteve të frikësimit të natyrave të ndryshme.



SHKRIMTARJA DHE FILOZOFJA LEA YPI NË AIDSSH

Tiranë, 18.07.2025

Kjo javë u mbyll me emocione në Autoritetin e Dosjeve. Shkrimtarja dhe filozofja Lea Ypi gjeti sërish gjurmë të reja të familjes së saj në dokumentet e arkivore të AIDSSH-së. Ajo ka tre vjet që vijon kërkimet në arkivin e AIDSSH-së dhe në arkiva të tjera, por surprizat që i solli kërkimi në AIDSSH këtë të premte ishte një ngjarje emocionuese jo vetëm për të.

Kryetarja e Autoritetit, shkroi në blogun e saj :



“Gjithçka ka ose një çmim, ose dinjitet - Cant”. Këtë frazë të fuqishme Lea Ypi e sjell në jetë në librin e saj të ri, **Indignity**.

Me një kopje paraprake në dorë (jam me fat këtu), shoqëruar me shënimin e saj të veçantë, ndej një lidhje të thellë me udhëtimin e saj nëpër arkivat e ish-Sigurimit, ku ajo zbulon gjurmët e paraardhësve dhe përballet me të vërteta të hidhura të historisë familjare dhe shoqërore. Sot, në vizitën në AIDSSH, Lea identifikoi foto të pa ekspozuara më parë të gjyshes Leman, gjyshit Asllan dhe të atit, Xhafer, atëherë i mitur. Këto do t'i shtohen këtij reflektimi mbi dinjitetin njerëzor, çmimin e së vërtetës dhe trashëgiminë që mbajmë.

Faleminderit, Lea, për këtë vepër që premtan të na prekë zemrat dhe mendjet! Mezi pres ta lexoj dhe të ndaj përshtypjet.

AIDSSH MIRËPRET ZËVENDËSAMBASADOREN BRITANIKE JULIA SUTHERLAND

Tiranë, 8 gusht 2025

Në ambientet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u zhvillua një takim mes znj. Julia Sutherland, Zëvendësshefe e Misionit Britanik në Shqipëri (Chargé d'Affaires), dhe znj. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH-së, si dhe ekipit që ajo drejton.



Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Britanike në Tiranë dhe u fokusua në prezantimin e punës së Autoritetit, si dhe shqyrtimin e mundësive për nisma të përbashkëta me Mbretërinë e Bashkuar.



Gjatë vizitës, znj. Sutherland u njoh nga afër me arkivin e Autoritetit, tipologjitë e dosjeve, fondet dhe interesin e lartë të studiuesve për këto burime historike. Më pas, u prezantuan projektet e kujtesës që kanë kontribuar në zbardhjen e të vërtetave të fshehura, si hartat dhe evidencat e vendeve të vuajtjes (Kampi i Tepelenës, Burgu i Spaçit), si dhe ngjarjet që tronditën dhe dëmtuan opozitën e kohës, duke e zhytur shoqërinë në izolim të plotë politik e ekonomik. Në takim u trajtuan edhe çështje që shënuan kulmin e diktaturës, si goditja e intelektualëve dhe të konsideruarve armiq të pushtetit, përmes dënimeve me vdekje dhe format e tjera të represionit, si burgime dhe survejimeve afatgjata.



U diskutua mbi organizimin e mundshëm të marrjes së ekspertizës mbi modelet britanike- irlandeze të pajtimit dhe ballafaqimit me të kaluarën; Hapësirën e mundshme për realizimin e një vizite studimore në Mbretërinë e Bashkuar për përfaqësues të AIDSSH-së, studiues dhe aktorë të kujtesës historike.

Znj. Sula vlerësoi rëndësinë e forcimit të kujtesës dhe transparencës mbi të vërtetat historike të regjimit komunist, si dhe rolin e partneriteteve ndërkombëtare në proceset e pajtimit shoqëror dhe institucional.

VALIASI – NGA KAMP NË PËRKUJTIM:

AUTORITETI KUJTON VIKTIMAT E KAMPEVE TË INTERNIMIT

Tiranë, 22 gusht 2025

Në përkujtim të Ditës Evropiane të kujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, Autoriteti organizoi aktivitetin përkujtimor “Valiasit – nga kamp në përkujtim”.

Ngjarja solli për publikun histori mbijetese, dëshmi të të internuarve dhe dokumente arkivore të zbuluara së fundmi. U shfaq dokumentari i Autoritetit “Ana tjetër e Valiasit”, i ndërtuar mbi dëshmitë e të mbijetuarve dhe të pasardhësve të familjeve të internuara.

Pamjet dhe rrëfimet treguan realitetin e kampit të punës së detyruar, ku sipas dokumenteve të vitit 1950, ishin të internuar 820 persona, mes tyre 372 fëmijë dhe dhjetëra gra.



Në fjalën e saj, Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, u shpreh: “Ky kamp, ku mbi gjysma e të internuarve ishin fëmijë, mbetet simbol i ndëshkimit kolektiv dhe traumës së shoqërisë sonë.

Plagët e Valiasit, të Kodër-Kamzës, të Tepelenës, të Porto-Palermos, Savrës, Grabianit, Spaçit e Burrelit, nuk janë plagë individuale. Ato janë plagë të shoqërisë sonë, të trashëguara brez pas brezi. Studiuesit e psikologët na kujtojnë se trauma nuk shërohet duke u mbuluar, por duke u njohur. Prandaj edhe ne, përmes këtij aktiviteti, zgjedhim të kujtojmë, të ndajmë dhe të njohim të vërtetën.



Ndaj ky dokumentar, si burim i rëndësishëm për platformën “Mësojmë nga e kaluara”, do të vijojë të informojë dhe të ftojë në reflektim mbi atë që trashëgojmë nga e shkuara dhe mbi mënyrën si e mbajmë të gjallë kujtesën jo vetëm për ne që jetojmë sot, por edhe për brezat që vijnë.

Shoqëria jonë ka nevojë jo vetëm të nderojë viktimat, por edhe të mësojë të njohë dhimbjen e tjetrit, që trauma e djeshme të mos bëhet burim përçarje sot e nesër.”

Z. Et’hem Fejzollari, kryetar i Shoqatës Antikomuniste të Përndjekurve Politikë Demokratë të Shqipërisë, dëshmitar i mbijetuar, solli kujtimet e tij si fëmijë i internuar në kampin e Valiasit:

“Valias ishte një kamp 5 - 6 m i gjatë dhe i rrethuar me tela me gjemba. Kishte roje me armë sipër. Kampi ishte një sallë e madhe origjinal si në Kamzë. Ndryshimi ishte se në Kamzë silllej një autobot me ujë çdo ditë dhe njerëzit e internuar merrnin ujë të pastër. Në Valias ishte vetëm një pus në mes të kampit pa gurë anash, i cili shembej çdo ditë dhe njerëzit mbushnin kovat me ujë të turbullt. Kush e ruante veten mblidhte shkarpa aty dhe e ziente që ta pinin. Pjesa më e madhe e pinin ashtu dhe i zinte dizenteria dhe i çonin nëpër spitale”

Z. Wojciech Unolt, i ngarkuari me punë i Ambasadës Polake tha se: “Polonia njih nga afër dhimbjen e kësaj historie. Populli ynë ka kaluar përmes vuajtjeve të dyfishta – nga barbaria e pushtimit nazist deri tek represioni i diktaturës komuniste. Përvoja jonë na mëson se kujtesa është mjeti më i fuqishëm për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë e më të lirë.

Prandaj, ne e mbështesim me forcë përpjekjen e Autoritetit për të sjellë në dritë dëshmitë e mbijetesës dhe për të kthyer kujtimin individual në një kujtesë kolektive. Ky është edhe kuptimi i Ditës Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare – një ditë e cila lindi nga iniciativa e vendeve që njohën nga afër plagët e komunizmit dhe të nazizmit, mes tyre edhe Polonia.”

Z. Gjergj Marku, anëtar i Autoritetit: “Sot jemi këtu për të kujtuar kampin e Valiasit dhe dhimbjen që mbartin dëshmitë e atyre që vuajtën në të dhe në kampet e tjera të internimit e punës së detyruar në Shqipëri. Kujtimi ynë sot është një akt nderimi për të gjithë ata që vuajtën. Vetëm nëse dëshmitë dëgjohen dhe respektohen, “plagët mund të shërohen” dhe shoqëria jonë mund të ecë përpara me guxim dhe me kujtesë.”

Z. Albert Nikolla: “Dëshmitë flasin” – kjo nuk është thjesht një shprehje, por një thirrje për të dëgjuar zërat e burrave, grave e fëmijëve që vuajtën e mbijetuan. Ata nuk na flasin që të mbetemi peng i së kaluarës, por që të ndërtojmë një të ardhme më të drejtë, duke e pranuar dhe respektuar të vërtetën. Kampi i Valiasit, si Tepelena, Porto-Palermo apo të gjitha kampet e tjera të internimit, mbeten dëshmi të gjalla të padrejtësive të regjimit totalitar. Aty, përveç lirisë së mohuar, u shkatërruan jetë, u shuan shpresa dhe u plagosën breza të tërë.”

Një mesazh sensibilizues përcolli edhe mjeku psikiatër dhe psikoterapist, z. Neli Demi, përmes një video-mesazhi mbi traumën e trashëguar dhe nevojën e përpunimit të kujtesës.

“Nëse nuk kujdesemi për plagët e së kaluarës, ato vazhdojnë të helmojnë të tashmen. Por kur kujtojmë me dinjitet, kur dëgjojmë me respekt, kur japim hapësirë për rrëfim e drejtësi, kujtesa bëhet mjet shërimi. Drejtësia riparuese është rruga që na mëson se historia nuk është vetëm një libër i mbyllur, por një proces i vazhdueshëm. Ajo na kujton se e kaluara mund të mbetet e rëndë, por e tashmja ka fuqinë ta shndërronjë atë në mësim dhe në forcë.”

Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me Shoqatën Antikomuniste të Përndjekurve Politikë Shoqatës Antikomuniste të përndjekurve Politikë dhe u pasua nga diskutime të familjarëve e të mbijetuarve, duke i kthyer dëshmitë dhe dokumentet në një memorie të përbashkët të shoqërisë shqiptare.

KUJTESË HISTORIKE MBI KAMPIN E VALIASIT

Dokumentet historike tregojnë se kampi i Valiasit u ngrit në vitin 1945, fillimisht për robërit gjermanë të luftës dhe më pas u përdor për familjarët e të arratisurve apo të dënuarve, kryesisht u grumbullua gra dhe fëmijë. Ai u mbyll në vitin 1952, duke transferuar të internuarit nëpër kampe të tjera.

Nga dokumentet arkivore që i përkasin viteve 1950–1952 (Fondi 4, Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit), numri i të



internuarve shkonte nga 376 deri në 820 persona, ku pjesa më e madhe ishin gra dhe fëmijë. Shumë prej tyre jetuan në kushte çnjerëzore, me ushqim minimal, mungesë higjienë dhe shpesh të prekur nga sëmundje si malaria e tuberkulozi.

Në një dokument të CIA-s të 12 majit 1951, kushtet e kampit përshkruhen si “të mjerueshme”: njerëzit jetonin në kasolle kashte, merrnin vetëm 500 gr. bukë në ditë dhe nuk kishin ujë të pastër. Në një tjetër dëshmi të kohës, regjimi vetë e përkufizon Valiasin si kamp përqendrimi.

AIDSSH-JA HOMAZHE PËR VIKTIMAT E KAMPIT FAMËKEQ TË TEPELENËS

NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË VIKTIMAVE TË TOTALITARIZMIT

Tepelenë, 23 gusht 2025

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, në ish-kampin e Tepelenës u zhvillua pelegrinazhi i përvitshëm për të kujtuar viktimat e internimeve dhe dëbimeve gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Në këtë aktivitet morën pjesë: anëtar i Autoritetit, z. Gjergj Marku, z. Et'hëm Fejzollari, kryetari i Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë, z. Malo Sadikaj, kryetar i Shoqatës Antikomuniste Tepelenë, si dhe shumë vuajtës e ish-të internuar të kampit, familjarë dhe të afërm të tyre.



Në fjalën e tij, z. Gjergj Marku foli për internim-dëbimet në Shqipërinë komuniste dhe historinë e kampit të Tepelenës, të cilin e cilësoi si “një plagë të hapur të kujtesës kombëtare”.

Ai theksoi se ky kamp mbetet simbol i vuajtjeve çnjerëzore, ku mbi 1500 familje u përqendruan në kushte ekstreme dhe ku vetëm në vitin 1950 humbën jetën mbi 280 fëmijë nga uria dhe sëmundjet.

“Është detyra jonë të mos lejojmë që historia të harrohet apo të shtrembërohet. Tepelena duhet të kthehet në një vend kujtese dhe edukimi për brezat e rinj”, u shpreh Marku.


Kampi i Tepelenës, i ngritur në vitin 1949, është përmendur edhe në dokumentet ndërkombëtare si shembull i shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste dhe mbetet një nga simbolet më të dhimbshme të internimeve në Shqipëri.

SIMPOZIUM ME TEMË

“KUFIRI I SHPRESËS DHE I VDEKJES NË VITET 1944–1991,

SHKODRA PËRBALLË SË KALUARËS”

Shkodër, 28 gusht 2025



Autoriteti i Dosjeve, në kuadër të 30 Gushtit – Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur - në bashkëpunim me universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, mbajti simpoziumin me temë: “Kufiri i Shpresës dhe i Vdekjes, 1944–1991; Shkodra përballë së kaluarës.”

Në aktivitet morën pjesë Kryetarja e Kuvendit, Elisa Spiropali, ambasadori i BE-së dhe ambasadori i OSBE-së, përfaqësues të dy institucione ndërkombëtare, të cilat që prej vitit 2017 bashkëpunojnë ngushtë me Autoritetin lidhur me trajtimin e çështjes së personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Të pranishëm ishin gjithashtu deputetja Greta Bardeli, përfaqësues të institucioneve publike, pushtetit vendor, përfaqësues të komuniteteve fetare, të afërm të viktimave dhe të mbijetuar.



Kryetarja e Kuvendit, Elisa Spiropali, theksoi:

“Ky simpozium nuk është thjesht një nderim për viktimat, por një akt përballjeje me të shkuarën. Një akt që i takon të gjithë shoqërisë, pa dallime politike apo ideologjike. Është detyrë e institucioneve demokratike, përfshirë Kuvendin, që të garantojnë mbështetjen për punën e institucioneve si Autoriteti i Dosjeve dhe Komisioni për Gjetjen e të Zhdukurve. Kërkimi për drejtësi nuk është hakmarrje, por përpjekje për të rikthyer dinjitetin e mohuar. Demokracia nuk përmbushet pa ndëshkimin e krimeve dhe pa njohjen e viktimave.”

Ambasadori i BE-së, Silvio Gonzato, u shpreh se ballafaqimi me të shkuarën është një domosdoshmëri, jo një opsion:

“Përballja me vrasjet në kufi dhe fenomenin e zhdukjes është çështje dinjiteti njerëzor. Demokracia është e fortë vetëm



kur drejtësia tranzitore zbatohet. Qyteti i Shkodrës duhet të kthehet në një vend kujtese, me muze dhe hapësira përkujtimore.”

Ai përcolli edhe shqetësimin e shumë ish-të përndjekurve që ende presin kompensimet, duke theksuar se ky proces nuk mund të shtyhet pa fund. Ambasadori përmendi gjithashtu bashkëpunimin me ICMP-në për hartimin e protokolleve të kërimit të personave të zhdukur.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, pranoi vonesa në ecurinë e procesit për rikuperimin e trupave të të zhdukurve gjatë regjimit komunist:

“Deri tani janë bërë hapa administrativë, por qetësia për familjet që ende nuk kanë një varr për të afërmin do të vijë vetëm kur të nisin gërmimet e para. Një Shqipëri që i gjen bijtë e vet është një Shqipëri më e mirë. Të vdekurit dhe ata që kanë vuajtur kërkojnë llogaridhënie historike; për të gjallët kjo është një mundësi për të bërë paqe me të shkuarën; dhe për të rinjtë, për të mbyllur plagët që u janë trashëguar brez pas brezi.”

Rektori i Universitetit, Tonin Gjuraraj, theksoi rolin e studimit shkencor:

“Detyra jonë është të hulumtojmë mbi dokumentet, të analizojmë dëshmitë dhe ta kthejmë këtë njohje në pjesë të ndërgjegjes kombëtare e të edukimit universitar. Kujtesa nuk duhet të mbetet e ngujuar në dhimbje, por të kthehet në një proces të vazhdueshëm kërkimi, mësimi dhe reflektimi. Harrimi është një formë e dytë e vdekjes – dhe ne nuk duhet ta lejojmë atë.”

Zëvendëskryetarja e Bashkisë Shkodër, Teuta Qyteza, u ndal te detyrimi institucional jo vetëm për të përkujtuar këto data, por edhe për të dokumentuar të vërtetën, për të edukuar brezat e rinj dhe për të mbështetur familjet e personave të zhdukur.

Në vijim, u prezantua nga Anila Zajmi projekti artistik për ngritjen e memorialit “Muri i Gjakut” në Shkodër, ide e deputetes Greta Bardeli, që do të shërbejë si hapësirë reflektimi dhe nderimi për viktimat e komunizmit.

Simpoziumi vijoi me prezantimet e punimeve nga 13 studiues nga trupa akademike e Universitetit të Shkodrës, institucione të tjera shkencore dhe studiues të pavarur. Kumtesat adresuan tema të tilla si: vrasjet në kufi dhe dhimbja e familjeve, mungesa e drejtësisë dhe rikthimi i së vërtetës historike, qëndresa e grave malësore përballë terrorit, mekanizmat e kontrollit dhe dhunës shtetërore, arratisjet e intelektualëve dhe klerit, trauma ndërbreznore dhe pasojat e saj.

Në hyrje të simpoziumit, AIDSSH-ja vendosi një ekspozitë me dokumente arkivore të krijuara nga Dega e Punëve të Brendshme, e cila hodhi dritë mbi mënyrën se si regjimi kishte ngritur një rrjet kontrolli, frike dhe ndëshkimi mbi qytetarët. Në mbi 6 000 faqe dokumentesh të ekspozuara dëshmohen fatet e mijëra individëve, institucioneve dhe vetë qytetit të Shkodrës, që për dekada u mbajt nën një kontroll të hekurt.



Nga dokumentet dhe dëshmitë u evidentuan kalimet e ndaluara në kufirin verior (Liqeni i Shkodrës, Buna, Hani i Hotit), ku për dekada u zhvilluan tragjedi njerëzore: qindra burra, gra dhe të rinj humbën jetën; të tjerë u arrestuan, u internuan apo u zhdukën pa gjurmë.

Në këtë simpozium u përkujtuar edhe viktimat e fundit të vrara në kufi në vitin 1990, mes tyre: Elez Kraja (29 vjeç), Dhurata Sokoli (24 vjeçe), Vat Beci (25 vjeç), Nini Hoti (25 vjeç), Pëllumb Pëllumbi (17 vjeç), Osman Xhakolli (23 vjeç) dhe tragjikisht Anisa Gruda, vetëm 5 vjeçe, e vrarë në Shirokë, ndërsa arratisëj me familjen e saj.

Ky simpozium e vendos Shkodrën në qendër të kujtesës historike, duke i dhënë një zë viktimave dhe një thirrje shoqërisë: Të mos harrojmë dhe të mos përsërisim kurrë më krimet e së shkuarës!



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni "Skënderbej", Tiranë